



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1135/Prot  
1

Tiranë, më 7 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 42, datë 7 . 10 . 2020

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Av. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 1135 Prot., datë 23.09.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Bankës OTP Albania Sh.a

Me shkresën datë 13.08.2020, ankuesi ka kërkuar nga Banka OTP Albania Sh.a:

- Të konfirmoni si të vërteta ose të kundërshtoni si të pavërteta, faktet/të dhënat që lidhen me informacionin e llogarisë AL1213110200000000000212353Eur, klient dhe , informacion i dhënë ose i padhënë nga OTP Bank më datë 03.07.2020 dhe i përdorur prej tyre në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në gjykimin e çështjes civile nr. 1730 viti 2020, kundër klientëve të përfaqësuar prej meje.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Banka OTP Albania Sh.a nuk ka kthyer përgjigje për sa është kërkuar, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*” ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative shoqërisë Banka OTP Albania Sh.a.

Nga verifikimi i kryer në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Banka OTP Albania Sh.a është një shoqëri tregtare, me aksione private, e zotëruar 100 % nga subjekti privat OTP Bank Nyrt dhe ushtron veprimtarinë e saj në fushën bankare.

Objekti i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar “*Autoritet publik*”: a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Nga verifikimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe parashikimeve të sipërcituara rezulton se Banka OTP Albania Sh.a nuk është autoritet publik, në kuptim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitimit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 1135 Prot., datë 23.09.2020, të Av. kundër Bankës OTP Albania Sh.a, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 7 .10 .2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

